



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 58, datë 01.06.2020

“PËR

**MARRJEN E MASAVE NGA BASHKIA TIRANË PËR OFRIMIN E ASISTENCËS
NDAJ SHITRESAVE NË NEVOJË NËPËRMJET PËRDORIMIT TË SASISË
USHQIMORE TË PAPËRDORUR NGA DREJTORIA E KONVIKTEVE TË
SHKOLLAVE TË MESME”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar, Ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar, Ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të vendimit nr. 243, datë 24.3.2020 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” të ndryshuar, Vendimit nr. 236, datë 19.03.2020 të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Marrjen e masave nga strukturat e Bashkisë Tiranë për ofrimin e asistencës ndaj shtresave në nevojë nëpërmjet ofrimit dhe shpërndarjes së pakove ushqimore në banesë në kuadër të masave të marra për mbrojtjen nga infeksioni COVID-19.
2. Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme nisur nga pezullimi i frekuentimit të konvikteve në këtë periudhë, në mbështetje të kontratave që kanë me operatorët privat për blerjen e produkteve ushqimore, të evidentojë sasinë ushqimore që mund të vendosë në dispozicion të Bashkisë Tiranë.
3. Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme ngarkohet të marrë masat e nevojshme për evidentimin e sasisë ushqimore dhe vendosjen e tyre në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social, me qëllim shpërndarjen e tyre nëpër banesa të shtresave në nevojë.
4. Në zbatim të këtij vendimi, me sasi ushqimore do të nënkuptojmë atë sasi ushqimore të papërdorur që nga momenti i mbylljes së konvikteve me urdhrat përkatës të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Kryetarit të Bashkisë Tiranë.
5. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, koordinon me të gjithë strukturat përkatëse dhe grupet e ngritura për këtë qëllim, për ndjekjen e procesit të grumbullimit dhe shpërndarjes së pakove ushqimore.

6. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ndjek procesin e grumbullimit dhe magazinimit të pakove ushqimore që do të vendosen në dispozicion nga Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme.
7. Ngarkohen Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R I

TONI GOGU